



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491*

Nr. 1015/50 Prot.

Tiranë, më 31/03/2016

**V E N D I M**

**Nr. 32, Datë 31/03/2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT**  
**“MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMITTË DETYRAVE DHE MASAVE TË**  
**REKOMANDUARA NË AUDITIN E MËPARSHËM”**

**USHTRUAR NË 43 SUBJEKTET E AUDITUARA NË VITIN 2015**

**BASHKITË: TIRANË, HIMARË, DROPULL, KUKËS, PUSTEC, DURRES, DIVJAKE, PUKE, KAVAJE, POGRADEC, KUÇOVE, PATOS, VLORË, FIER, SELENICË, MEMALIAJ, DIVJAKË DHE KOLONJË;**

**NJESITË ADMINISTRATIVE: FUSHË-KRUJE (BASHKIA KRUJE), PERONDI (BASHKIA KUÇOVË), MAMURRAS (BASHKIA KURBIN), XHAFZOTAJ (BASHKIA SHIJAK), GRADISHTË (BASHKIA DIVJAKË), DAJT (BASHKIA TIRANË), KOTË, VLLAHINË, ARMEN, (BASHKIA SELENICË), ORIKUM DHE NOVOSELË (BASHKIA VLORË), ÇËRAVE (BASHKIA POGRADEC), GRYKË ÇAJË, (BASHKIA KUKËS), XARË (BASHKIA KONISPOL), BRADASHESH (BASHKIA ELBASAN), FAN (BASHKIA MIRDITË), LIVADHJA (BASHKIA FINIQ), PREZË (BASHKIA VORË) SHËNGJIN (BASHKIA LEZHË);**

**UJËSJELLËS Sha BERAT-KUÇOVE, ALUIZNI KORÇË DHE FIER, ZVRPP-POGRADEC, KRUJE DHE SARANDË DHE PREFEKTURA SHKODER.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 10, 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetari të KLSH, nr. 3, datë 03.11.2015 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**V E N D O S A:**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar Përmbledhës të Auditimit "Mbi verifikimin e**

zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin për vitin 2015”.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

Në 43 subjektet e verifikuara për zbatim rekomandimesh rezultoi një nivel zbatueshmërie në masën 70%, nga 856 masa organizative të rekomanduara ishin zbatuar apo janë në proces zbatimi 584 masa, nga të cilat ishin zbatuar plotësisht 256 masa dhe 328 masa janë në proces zbatimi.

Nuk pranohen të zbatohen nga 28 subjekte 163 masa dhe 109 masa nga 12 subjekte nuk kanë qenë të mundura të zbatohen, për arsye të reformës territoriale, ku një pjesë e tyre ezaurohen me përthithjen nga Bashkitë e mëdha, të cilët do të mbartin edhe detyrimet që u përkasin ish-komunave.

Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH janë: ZVRPP Pogradec 20 masa, Bashkia Pogradec dhe Kuçovë (nga 10 masa secila), Bashkia Fier (9 masa).

### **1. BASHKIA TIRANË**

Nga KLSH janë rekomanduar gjithsej 29 masa organizative nga të cilat janë zbatuar apo janë proces realizimi 17 masa, ndërsa për masat organizative të pa zbatuara do rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1. Bashkia Tiranë, të marrë masat e nevojshme ligjore, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **14,722,760 lekë**, sipas Urdhrit të ish-Kryetarit të Bashkisë nr. 8178/61, datë 2.7.2015 mbi “Marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të kërkuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Bashkinë e Tiranës” .
2. Bashkia Tiranë të marrë masa për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **12,806,675 lekë**, që përfaqëson llogaritjen e 20% tvsh për pajisjet e aparaturat, duke preventivuar e konkurruar në tender, me konsiderimin punime ndërtim montimi, nga subjektet preventivues për **10 objektet** si më poshtë:
  - Për 4 objektet për të cilat preventivat e hedhur në tender janë hartuar nga Kompania ████████ **respektivisht:**
    - Objekti: “Rikonstruksioni i Çerdhes Nr. 15 Tiranë” me vlerën **555,488 lekë**;
    - Objekti: “Rikonstruksioni i Çerdhes Nr. 30 Tiranë” me vlerën **545,260 lekë**;
    - Objekti: “Rikonstruksioni i Çerdhes Nr. 35 Tiranë” me vlerën **617,789 lekë**;
    - Objekti: “Rikonstruksioni i Çerdhes Nr. 50 Tiranë” me vlerë **752,552 lekë**;
  - Objekti: “Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare Ahmet Gashi -Faza e Parë Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga Kompania private ████████, me vlerë **1,889,696 lekë**;
  - Objekti: “Rikonstruksion dhe Shtesë e Re e Shkollës Mesme Eqerem Çabej (Faza e Parë) Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga A.B. me vlerë **3,998,211 lekë**;
  - Objekti: “Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare në zonën e ish Kombinatit -Faza e Parë

- Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga Kompania private [REDACTED], me vlerë **2,199,729** lekë;
- Objekti: “Rikonstruksion i Rrugës Endri Keko Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga Kompania Studio [REDACTED], me vlerë **437,200 lekë**;
  - Objekti: “Rikonstruksioni i Kopshtit Nr. 31 Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga Sh.B. me detyrë preventivuese, me vlerë **213,150 lekë**.
  - Objekti: “Rikualifikim urban i parkut tek ish Fusha e Aviacionit (faza e dytë) Tiranë”, për hartuesin e preventivit të hedhur në tender nga Sh.B. me detyrë preventivuese, me vlerë **1,597,600 lekë**.
- 3.** Bashkia Tiranë të analizojë procedurat e ndjekura, lidhur me vjedhjen e aseteve nga viti 2013 në ish-Stacionin Hekurudhor të Tiranës në **vlerën 525,960,955 lekë**.  
Të kryhet vlerësimi me komision i aseteve të tjera të konstatuara të vjedhura si: 276 ml gardh hekuri, 488 ml linjë hekurudhore, dhe 22 copë ndërrues shinash duhet nxjerrë përgjegjësinë administrative dhe ligjore të personave të ngarkuar për ruajtjen e marrjen në dorëzim të tyre.
- 4.** Nga auditimi ka rezultuar se Policia Bashkiake Tiranë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, ka vendosur për vitet 2012-2014, gjithsej 2353 gjoba në vlerën 2,387,500 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 1546 gjoba për vlerën 1,408,854 lekë, **duke mos u arkëtuar 806 gjoba për vlerën 978,646 lekë**.
- 5.** Për periudhën vitit 2013 dhe 4-mujorin e vitit 2015, nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMTV), Bashkia Tiranë janë vendosur një numër i konsiderueshëm gjobash ndaj subjekteve ndërtimore të konstatuara me shkelje ligjore. Sipas të dhënave kontabël të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, janë pa vjelë **886 raste gjobash** ndaj personave fizikë dhe juridikë në shumën **550,107,477 lekë**, nga të cilat:
- Për vitin 2013 në shumën 321,817,412 lekë për 461 raste;
  - Për vitin 2014 në shumën 169,690,065 lekë për 375 raste;
  - Për 4-mujorin e parë 2015 në shumën 58,600,000 lekë për 50 raste.
- Nga verifikimi rezultoi se 2 rekomandimet e mësipërme nuk janë zbatuar, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë, ka hasur vështirësi në ekzekutimin e këtyre vendimeve, problem të cilin e ka trajtuar edhe në shkresën e saj nr. 7653, datë 24.12.2015, dërguar KLSH, ku sqaron se padrejtësisht është ngarkuar për dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për vjeljen e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake.  
Mënyra që ndjek aktualisht IMTV e Bashkisë Tiranë, për ekzekutimin e gjobave, të vendosura prej saj, ku vendimet e gjobave pavarësisht se dërgohen për tu ekzekutuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tregjeve dhe Taksave, Tiranë, nxjerrja e njoftim vlerësimit tatimor, për ekzekutimin e vendimeve të gjobave

nga Drejtoria e Përgjithshme e Tregje-Taksave Tiranë, nuk është e mbështetur në dispozitë ligjore, pasi njoftim vlerësimi tatimor nxirret vetëm për detyrimet që lindin nga tatimpaguesit, sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 për “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) ,neni 70 -E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor - pika 3 ku përcaktohet se: *Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël.*

**Rekomandimi:** (Për pikat 4 dhe 5). Duke u gjendur para një precedenti juridik me mundësi potenciale për pavlefshmërinë e vendimeve të Gjjobave të nxjerra nga IMTV dhe Policia Bashkiake Tiranë, në lidhje me vjeljen e 886 gjobave të vendosura nga IMTV në vlerën 550,2107,477 lekë dhe 806 gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake Tiranë për vlerën 978,646 lekë, KLSH rekomandon si më poshtë:

Procedura e ekzekutimit të vendimeve të gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, të cilat kanë marrë formën e prerë të kryhet në pajtim me kuadrin ligjor si më poshtë:

- ligjin nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar në nenin 16, ku përcaktohet se: *Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.*
- ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010”Për kundërvajtjet administrative”, neni 22 ku përcaktohet se: *Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë i vendosur nga organi administrativ i përmendur në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor.*

## **BASHKIA TIRANË (NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJT)**

1. Bashkia Tiranë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH në ish-Komunën Dajt, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës **5,031,253 lekë**, nga të cilët **janë në proces gjyqësor 2 subjekte në vlerën 3,017,529 lekë**, ndërsa kanë dalë urdhrat ekzekutiv për shpërblimin e dëmit për 2 subjekte në vlerën **prej 2,014,724 lekë**.
2. Bashkia Tiranë të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimor, për ekzekutimin 34 vendime administrative dënim me gjobë nxjerre nga ish-IMTV, ish-komuna Dajt në vlerën **6,880,000 lekë**.

## **2. BASHKIA VLORE**

- a. KLSH me shkresën nr. 348/10, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë,

që të kërkojë në Këshillin Bashkiak Vlorë, **revokimin e kontratës së koncesionit nr. 496**, datë 06.02.2015, me objekt “Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”. Nga verifikimi rezultoi se kjo masë nuk është zbatuar.

Bashkia Vlorë për këtë problem sqaron se: *Zgjidhja në mënyrë të njëanshme e kësaj kontrate, do të bëhej shkak për të penalizuar financiarisht Bashkinë Vlorë nga shoqëria koncesionare, çka do të pasqyrohej në mungesën e ofrimit të investimeve dhe shërbimeve për komunitetin. Bashkia Vlorë po mundohet të gjejë zgjidhjen më të favorshme në zbatim të ligjit dhe në funksion të interesave të komunitetit që përfaqëson.* Me këtë argumentim KLSH nuk është dakord dhe **do të rikërkojë revokimin e kontratës së koncesionit nr. 496**, datë 06.02.2015, me objekt “Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”.

b. KLSH me shkresën nr. 707/14, datë 30.06.2014, përsëritur me shkresën nr. 1128/58, datë 19.03.2015, i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë, që të nxjerr aktet administrative për arkëtimin e dëmit ekonomik **në vlerën 44,499,901 lekë**, nga operatori ekonomik ██████ sh.p.k, për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për “Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit”. Nga verifikimi rezultoi se kjo masë nuk është zbatuar.

KLSH nuk ka qenë dakord me pretendimin e Bashkisë Vlorë se nuk mund të kërkonte shpërblimin e dëmit ndaj operatorit ekonomik ██████ shpk, për vlerën 44,491,901 lekë, me arsyetimin se ka kaluar afati ligjor i kërimit të dëmit. Duke sqaruar se kontrata e shërbimit të pastrimit është me afat 5 vjeçar duke filluar më datën 02.02.2009 deri 02.02.2014, pra jemi brenda afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil.

Në se nuk filloni procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e dy rekomandimeve të mësipërme, KLSH do të kërkojë pranë organeve të prokurorisë që personat fajtorë të përgjigjen për shpërdorim detyre, respektivisht:

-Për mos kërkimin e **revokimit të kontratës së koncesionit nr. 496**, datë 06.02.2015, me objekt “Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës” dhe,

-Për mos kërkimin e **shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 44,499,901 lekë**, nga operatori ekonomik ██████, për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për “Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit”, për të cilin kanë kaluar edhe afatet ligjore të kërimit të dëmit të parashikuara në nenin 115 shkronja (dh), të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994”Për Kodin Civil në R.SH” i ndryshuar.

### **BASHKIA VLOREË (NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM DHE NOVOSELË)**

Nga KLSH i është rekomanduar ish-Bashkisë Orikum që të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore, për zbatimin rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **3,143,210 lekë** respektivisht, ndaj K.B. në vlerën 1,571,605 lekë dhe R.M. në vlerën 1,571,605 lekë, për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit. Për kërkimin e shpërblimit të dëmit më datën 12.11.2015 është bërë regjistrimi i kërkesë padisë në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, për të cilën kërkojmë nga Bashkia Vlorë të ndiqen në

vazhdimësi të gjitha shkallët e gjykimit, për këtë çështje.

1. Nga Bashkia Vlorë, për rekomandimet e dërguara ish-komunës Novoselë, në lidhje me sipërfaqen prej 52.9 ha të zaptuar dhe që shfrytëzohet nga fermerët, të kryhen verifikimet në terren dhe azhurnime përkatëse, duke ndjekur më pas procedurat e nevojshme ligjore për dhënien me qira të tyre. Të hapet regjistri për evidentimin e detyrimit ligjor për shumën totale **1,848,138 lekë** (taksë toke 633,680 lekë + 1,214,458 lekë tarifë qiraje).
2. Nga Bashkia Vlorë, për rekomandimet e dërguara ish-komunës Novoselë, të merren masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore, për 60 subjekte debitorë të Biznesit vogël, në pajtim me nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimet tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe për arkëtimin e vlerës prej **10,177,217 lekë**, të ndjekë procedurat ligjore si më poshtë:
  - a) Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.
  - b) Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Transportit vendosja e barrës siguroese (për mjetet) apo Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, të ndryshuar.

### 3. **BASHKIA SELENICË**

Nga verifikimi i zbatimit rekomandimeve të KLSH, rezultoi se nga 11 masa organizative të rekomanduara nga KLSH, për arsye të reformës administrative për 9 prej tyre nuk është bërë i mundur zbatimi, për 2 rekomandimet rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

- a) Bashkia Selenicë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH për arkëtimin e vlerës **3.408.185 lekë** të përfshira në kontabilitet që përkasin detyrimeve me origjinë të tretëve para vitit 2012.
- b) Bashkia Selenicë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **79,420,147 lekë**, detyrime të krijuara në ish-komunën Vllahinë, përkatësisht: taksa mbi tokën bujqësore në vlerën 69,265,407 lekë dhe taksën e biznesit të vogël në vlerën 10,154,740 lekë.

### 4. **BASHKIA FIER**

Nga verifikimi i zbatimit rekomandimeve të KLSH, rezultoi se nga 27 masa organizative, janë në proces zbatimi 10 masa dhe janë zbatuar plotësisht 7 masa, ku vlen për tu përmendur zbatimi i rekomandimit për shfuqizimin nga Këshilli Bashkiak Fier, me vendimin nr. 14, datë 27.07.2015, të kontratës nr. 1375/2, datë 27.12.2011 “Për kryerjen e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjektit [REDAKTUAR]. Gjithsesi në kushtet kur nuk kanë gjetur zbatim të plotë disa nga rekomandimet e KLSH, rikërkojmë sërish zbatimin e tyre si më poshtë:

1. Bashkia Fier të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 1016/25, datë 30.06.2014, të pa zbatuara plotësisht ose pjesërisht, për 8 masa organizative me vlerë 67,246,104 lekë dhe 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 62,881,274 lekë.
2. Bashkia Fier të marrë masat duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve të krijuar në vite, për vlerën **57,435,431 lekë**, nga e cila vlera **12,297,467 lekë**, detyrime të rekomanduara nga auditimet e mëparshme të KLSH.
3. Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Fier që të marrë masa për arkëtimin nga 49 subjekte debitorë në vlerën 2,614,175 lekë dhe nga verifikimi rezultoi se deri më datën 30.11.2015 ishte arkëtuar nga 20 subjekte vlera 589,429 lekë, duke mbetur debitor edhe 29 subjekte në vlerën 2.024,626 lekë. Sa më sipër Bashkia Fier të marrë masa për vazhdimin e proceduarve ligjore për arkëtimin e tyre, ku përveç dërgimit të urdhrave të bllokimit të llogarive në Banka e cila është kryer, ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Transportit vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, (për pasuritë e paluajtshme), bazuar nënin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", të ndryshuar.
4. Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Fier, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave për 7 subjekte për të cilat pretendohet se dokumentacionin e ka bllokuar Prokuroria e rrethit Gjyqësor Fier në shumën **4,100,000 lekë**.

## 5. **BASHKIA MEMALIAJ**

Nga KLSH janë rekomanduar 28 masa organizative, nga të cilat 12 masa janë zbatuar plotësisht, 9 masa janë në proces, 2 masa nuk janë zbatuar, sa sipër rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1. Nga Bashkia Memaliaj, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 978/8, date 19.12.2012 dhe konkretisht të vazhdojnë procedurat ligjore (akt padi gjyqësore) për shpërblimin e detyrimeve të prapambetura për 8 subjekte në shumën **3,017,750 lekë**, konkretisht subjektet: ████████ shpk, për shumën 1,228,180 lekë; subjekti ████████ shpk në shumën 140,000 lekë, subjekti fizik, ████████ shpk 71,831 lekë, ████████ shpk shuma 488540 lekë; Subjekti ████████ shpk në 3 raste në shumën 54,125 lekë dhe Subjekti ████████ shpk në vlerën 1,035,074 lekë.
2. Nga ana e Zyrës Taksave të Bashkisë Memaliaj, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimit

tatimore , për 192 subjekte debitorë në vlerën prej **22,091,538 lekë**, duke vepruar si më poshtë:

- a) Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore".
- b) Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", të ndryshuar.
- c) Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore", të ndryshuar, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Në 43 subjektet e verifikuara nga vlera e rekomanduar prej **590,169 mijë lekë**, pranohen dhe janë në proces zbatimi vlera 553,670 mijë lekë, ose ne masën 90%, duke mos u zbatuar vlera prej **36,491 mijë lekë**, nga e cila vlera prej 18,777 mijë lekë, nuk realizohen për arsye objektive duke mos u pranuar nga 5 subjekte vlera prej **17,714 mijë lekë**.

Sqarojmë se nga vlera e rekomandimeve prej **590,169 mijë lekë**, deri më datën 31.12.2015 gjendja paraqitet si më poshtë:

- 14 subjekte në vlerën **445,490 mijë lekë**, janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë për kryerjen e ndalesave dhe janë në proces zbatimi.
- 10 subjekte në vlerën **9,869 mijë lekë**, një pjesë janë arkëtuar apo janë në proces arkëtim.
- 4 subjektet në vlerën **55,854 mijë lekë** janë në proces gjyqësor civil apo penal (Bashkia Kolonjë, Dropull etj).
- 8 subjekte nuk i kanë pranuar, rekomandimet e KLSH për vlerën **36,491 mijë lekë** nga e cila 2 subjekte për arsye objektive në vlerën 18,777 leke (Bashkia Tiranë në vlerën prej 13,932 mijë lekë, detyrime të ndërmarrjeve të vartësisë), ndërsa vlera prej **17,714 mijë lekë**, e cila nuk pranohet për arsye të ndryshme dhe të pa argumentuara ligjërish nga 5 subjekte, prandaj KLSH do rikërkojë shpërblimin e dëmit në vlerën prej **17,714 mijë lekë për 5 subjektet** si më poshtë:
  1. **Bashkia Fier** për vlerën **8,979 mijë lekë**, për paga dhe shpërblime për punonjësit.
  2. **Bashkia Patos** për vlerën **6,465 mijë lekë**, nga mosllogaritja e sakte e fondit limit, etj.
  3. **Bashkia Kavajë** në vlerën **657 mijë lekë**, shpenzime për karburant përdorur nga administrata e Bashkisë pa u justifikuar me dokumentacionin e nevojshëm.
  4. **Bashkia Divjakë** në vlerën **1.317 lekë**, kërkuar zhdëmtimi nga anëtarët e KVO, por Bashkia Divjakë, pretendon se janë gjetur dokumentet e skualifikimit, të firmës fituese prandaj nuk është dakord që të zhdëmtohen nga anëtarët e KVO



Në mënyrë më të detajuar masa për shpërblim dëmi paraqitet si më poshtë:

## **1. BASHKIA TIRANË**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Tiranë shpërblimin e dëmit në vlerën **90,362,508 lekë**. Nga verifikimi rezulton se detyrimet e mësipërme janë pranuar nga Bashkia Tiranë, janë kontabilizuar, duke njoftuar edhe subjektet përkatëse, por për arsye të pritjes së afatit 30 ditor të ankimimit, sipas Kodit të Procedurës Civile, sipas shkresës Bashkisë Tiranë nr. 21274/1prot, datë 15.12.2015, ndalesat do tu kryhen subjekteve në situacionet që do paraqiten për tu likuiduar me çeljen e buxhetit për vitin 2016.

Sa më sipër përsërisim rekomandimin si më poshtë:

1. Bashkia Tiranë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore dhe administrative të detyrimit që kanë subjektet e pastrimit të qytetit të Tiranës, të cilët kanë përfituar padrejtësisht diferencën e ndryshimit të volumeve të shërbimit me në **vlerë totale 48,088,227 lekë**, për 4 operatorët ekonomik të mëposhtëm:
  - a) Operatori ekonomik [REDAKTUAR] në vlerën **5,896,927 lekë**
  - b) Operatori [REDAKTUAR] në vlerën **2,719,389 lekë**
  - c) Operatori ekonomik [REDAKTUAR] në vlerën **17,445,610.50 lekë**
  - d) Operatori ekonomik [REDAKTUAR] në vlerën **22,026,301 lekë**
  - e) Bashkia Tiranë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik nga 4 subjektet respektivisht: [REDAKTUAR] shpk për shumën **384,120 lekë**, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] për shumën **361,799 lekë**, bashkimi i operatorëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shumën **180,400 lekë** dhe bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR], për shumën **3,721,884 lekë**.

## **BASHKIA TIRANË (NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJT)**

Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për ish-komunën Dajt në vlerën **940,932 lekë**, nuk janë kryer veprimet për ti regjistruar në kontabilitet si debitorë, ndërkohë deri më datën 07.12.2015 është arkëtuar vetëm nga 4 subjekte vlera 76,480 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar edhe vlera prej 864,452 lekë, prandaj **i rikërkojmë** Bashkisë Tiranë që të marrë masat si më poshtë:

- a) për kontabilizimin dhe arkëtimin e shumës **95,700 lekë** (pa tvsh), sa përfituar tepër nga firma fituese [REDAKTUAR]
- b) për kontabilizimin dhe arkëtimin e shumës **244,302 lekë** (pa tvsh), sa përfituar tepër nga firma fituese [REDAKTUAR]
- c) Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore, të Njësisë administrative Dajt, bazuar në njoftim vlerësimet e nxjerrë në zbatim të nenit 70, pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të vazhdojë procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat vendore për periudhën 2013-2014, nga 27 subjektet e biznesit për **vlerën 600,930 lekë**

## **1. BASHKIA VLORE**

KLSH me shkresën nr. 707/14, datë 30.06.2014, përsëritur me shkresën nr. 1128/58, datë 19.03.2015, i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë, që të nxjerr aktet administrative për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **44,499,901 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k, për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për “Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit”.

**Nga verifikimi rezultoi se kjo masë nuk është zbatuar.**

KLSH nuk ka qenë dakord me pretendimin e Bashkisë Vlorë se nuk mund të kërkonte shpërblimin e dëmit ndaj operatorit ekonomik [REDAKTUAR] për vlerën 44,491,901 lekë, me arsyetimin se ka kaluar afati ligjor i kërimit të dëmit. Duke sqaruar se kontrata e shërbimit të pastrimit është me afat 5 vjeçar duke filluar më datën 02.02.2009 deri 02.02.2014, pra jemi brenda afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil.

**Prandaj do i rikërkojmë Bashkisë Vlorë përsëri zbatimin e këtij rekomandimi.**

### **BASHKIA VLORE (PËR DETYRIMET E ISH-KOMUNËS NOVOSELË)**

a-Nga Bashkia Vlorë, të ndiqen të gjitha procedurat administrative gjyqësore për arkëtimin e dëmit ekonomik nga subjekti [REDAKTUAR] për vlerën **144,200 lekë**, përfituar padrejhtësisht, si rrjedhojë e preventivimit të pajisjeve të llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në objektin “Shkolla e Re Poro, Komuna Novoselë”.

b-Duke qenë se për shpërblimin e dëmit ekonomik prej **8,996,440 lekë**, në objektin “Rikonstruksioni i rrugës Hidrovor Akërrni faza e II”, çështja është në proces gjyqësor, nga Bashkia Vlorë të vazhdojë ndjekja në gjitha shkallët e gjykimit respektivisht ndaj K.Sh. ish-kryetar i Komunës Novoselë për vlerën 4,498,220 lekë dhe ndaj Sh.M. ish-punonjëse e urbanistikës për vlerën 4,498,220 lekë.

### **-BASHKIA VLORE (PËR DETYRIMET E ISH- KOMUNËS ORIKUM)**

Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet arkëtimi i dëmit ekonomik prej **1,548,950 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit Mustafa Qemal Ataturku”, duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, pasi për këtë çështje më datën 01.09.2015, ka filluar procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

## **2. BASHKIA SELENICË**

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH, rezultoi se janë pranuar rekomandimet për masa për shpërblim dëmi për Bashkinë Selenicë dhe dëmin e krijuar nga 3 ish-Komunat, Armen, Kotë dhe Vllahinë, përveç rasteve të mëposhtme:

1. Nga vlera e rekomanduar për Bashkinë Selenicë për shpërblim dëmi prej **32,017,457 lekë**, është arkëtuar vlera 2,513,600 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 29,503,857 lekë, nga e cila janë në proces gjyqësor 3 persona në vlerën 325,500 lekë, ndërsa 5 subjekteve edhe pse u janë nisur njoftime, ende nuk

kishte filluar arkëtimi për vlerën 29,503,857 lekë. Prandaj i **rikërkojmë** Bashkisë Selenicë vazhdimin e procedurave ligjore duke hartuar (padi gjyqësore), për arkëtimin respektivisht nga subjektet: [REDAKTUAR] në vlerën 3,456,840 lekë, [REDAKTUAR] në vlerën 8,676,840 lekë [REDAKTUAR] në vlerën 7,009,200 lekë [REDAKTUAR] nga 1,125,030 lekë ka arkëtuar vlerën 1,000,000 lekë, duke mbetur edhe vlera prej 125,030 lekë dhe [REDAKTUAR] nga detyrimi prej 2,291,705 lekë, ka arkëtuar vlerën prej 1,500,000 lekë, duke mbetur për tu arkëtuar edhe vlera prej 791,705 lekë.

2. Bashkia Selenicë të kryhej kontabilizimet e detyrimeve të krijuara **nga ish-komuna Armen**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 32.362,900 lekë pa tvsh** të detajuara si më poshtë:
  - **Vlera 8,341,730 lekë pa tvsh nga subjekti [REDAKTUAR]** për punime të pakryera.
  - **Vlera 10,248,519 lekë**, nga hartuesit e projektit dhe preventivit të objektit “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen” përkatësisht nga zj Y.Y. për vlerën 5.124.259 lekë dhe K.Sh. për vlerën 5.124259 lekë
  - **Vlera 6,176,600 lekë**, për punime të pakryera nga bashkimi i operatorëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] shpk.
  - **Vlera 1,296,900 lekë** për mos pagesën e ujit të pijshëm nga 392 konsumatorë familjarë .
  - **Vlera 980,000 lekë** nga 36 subjekte transporti të cilat ushtrojnë aktivitet transport mallrash për nevojat e veta pa qenë të regjistruara në QKR.
  - **Vlera 517,307 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e sigurimit të ofertës të OE [REDAKTUAR] shpk.
3. Bashkia Selenicë të kryejë kontabilizimet dhe të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së krijuar **nga ish- Komuna Kotë për shumën 9,977,760 lekë** të detajuara si më poshtë:
  - **Vlerën 422,400 lekë**, nga 21 përdoruesit të ngastrave të marra me qira nga fondi i tokave të pandara.
  - **Vlerën 850,200 lekë**, nga 7 qiramarrësit e objekteve pronë të ish-Komunës Kotë për aktivitet tregtar dhe banim.
  - **Vlerën 1,254,700 lekë**, nga **119 përdoruesit** të parcelave të marra me qira nga fondi kullësor pronë ish-Komunës Kotë.
  - **Vlerën 356,200 lekë**, përfituar tepër nga subjekti [REDAKTUAR] për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i Urës Vodice e punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë”.
4. Bashkia Selenicë të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore (me Padi gjyqësore) arkëtimin e **detyrimeve të krijuara në ish-Komunën Vllahinë** për vlerën **9,763,802 lekë**, si më poshtë:
  - a) **Vlerën 5,024,000 lekë**, detyrim i pa arkëtuar për konsumin e ujit të pijshëm nga familjet e fshatit Vllahinë, Peshkëpi dhe Kocul dhe ti pasqyrojë në dokumentet kontabël.
  - b) **Vlerën 3,868,615 lekë**, pa tvsh, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] për punime të

pa kryera në zbatimin e kontratës nr.1008 prot., datë 09.11.2012 me objekt “Punime me ujësjellësin e Komunës Vllahinë”.

- c) **Vlerën 294,887 lekë**, qira e pa paguar përkatësisht nga N.Ç. në vlerën 40,500 lekë, A.V. në vlerën 90,337 lekë dhe F.M. në vlerën 164,050 lekë.
- d) **Vlerën 216,000 lekë**, nga dy punonjësit paguar më tepër se sa përcaktohet në pikat 18, 19, 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- e) **Vlerën 331,500 lekë**, taksë e kalimit në pronësi të përfitueseve të tokës bujqësore nga 187 familje në fshatin Vllahinë dhe 34 familje në fshatin Petë.
- f) **Vlerën 28,800 lekë**, qira e pa paguar nga A.I.

### 3. **BASHKIA FIER**

Nga shuma e rekomanduar nga KLSH për shpërblim dëmi në vlerën **11,312,948 lekë**, janë pranuar për tu arkëtuar dhe janë kryer regjistrimet në kontabilitet për vlerën **1,122,001 lekë**, ndërkohë nuk janë nxjerr vendimet ekzekutive dhe nuk janë kryer regjistrimet në kontabilitet si debitorë, **duke mos u pranuar** për arkëtim vlerën **10,119,547 lekë**, për të cilën do i rikërkojmë Bashkisë Fier, zbatimin e këtij rekomandimi respektivisht:

- a) për fillimin e ndalesave ndaj 6 punonjësve dhënë shpërblim page nga fondi i veçantë në vlerën 354,600 lekë.
- b) për fillimin e ndalesës ndaj 13 punonjësve paguar më tepër se Tabela e pagave në vlerën 1,712,355 lekë.
- c) për fillimin e arkëtimit të vlerës qirave nga individët në vlerën 4,723,812 lekë.
- d) për fillimin e arkëtimit të vlerës qirave për 19 familje në vlerën 3,328,780 lekë.

### 4. **BASHKIA PUSTEC**

Nga KLSH me shkresën nr. 256/6 prot., datë 18.6.2015, i ka rekomanduar Bashkisë Pustec, për shpërblimin e dëmit me vlerë **1,241,072 lekë** nga 24 subjekte. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga Bashkia Pustec, e cila i ka kthyer përgjigje KLSH-së me shkresën nr. 61/1 prot., datë 30.06.2015. Është arkëtuar shuma 66,000 lekë, është në proces diferenca për shumën 1,175,072 lekë. Për këtë shumë, është nxjerrë urdhri i titullarit të bashkisë për nxjerrjen debitor, janë kontabilizuar veprimet dhe janë njoftuar personat debitorë. Janë kryer regjistrimet kontabël për vlerën e debisë 1,969,068 lekë, nuk ka filluar detyrimi i arkëtimit, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre**.

### 5. **BASHKIA KOLONJË**

Nga KLSH, me shkresën nr. 110/8 prot., datë 14.5.2015, i ka rekomanduar Bashkisë Kolonjë, për shpërblimin e dëmit me vlerë **14,769,000 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga Bashkia Kolonjë, e cila i ka kthyer përgjigje KLSH-së me shkresën nr. 313 prot., datë 14.9.2015, duke u arkëtuar shuma 12,500 lekë, është në proces diferenca për shumën **14,756,500 lekë**.

Për këtë shumë, është nxjerrë urdhri i titullarit të bashkisë për nxjerrjen debitor, janë kontabilizuar veprimet dhe janë njoftuar personat debitorë. Për shumicën e personave debitorë, janë bërë padi në gjykatë për arkëtimin e vlerës debitorë, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **6. BASHKIA HIMARË**

Nga KLSH me shkresën nr. 770/20 prot., datë 30.1.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Himarë, për shpërblimin e dëmit me vlerë **86,539,618 lekë.**

Nga Bashkia Himarë janë pranuar rekomandimet e KLSH dhe për arkëtimin e detyrimit nga personat debitorë, titullari i bashkisë, për çdo rast, ka nxjerrë urdhër zhdëmtimi. Për zbatimin e urdhër zhdëmtimeve, janë ngarkuar Drejtoria Ekonomike dhe Zyra Juridike e Bashkisë Himarë. Janë bërë njoftimet e debitorëve, por regjistrimet kontabile nuk ishin kryer dhe arkëtimi i shumave nuk ka filluar, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **7. BASHKIA KONISPOL (ISH-KOMUNA XARRË)**

Nga KLSH me shkresën nr. 564/7 prot., datë 10.9.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Konispol për shpërblimin e dëmit me vlerë **2,742,646 lekë** të konstatuar në ish-Komunën Xarrë.

Nga verifikimi rezultoi se këto rekomandime nuk ishin zbatuar, por me shkresën nr. 946, datë 2.12.2015, Bashkia Konispol, **i ka pranuar** këto detyrime duke dërguar në KLSH planin e veprimit. Nëpunësi autorizues, ka nxjerr urdhra për njoftimin e debitorëve dhe regjistrimin kontabël të detyrimeve por nuk ka filluar ende arkëtimi i shumave, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **8. BASHKIA FINIQ (ISH-KOMUNA LIVADHJA)**

Nga KLSH me shkresën nr. 241/7 prot., datë 20.06.2015 i ka rekomanduar ish-Komunës Livadhja për shpërblimin e dëmit me vlerë **1,439,650 lekë.** Nga verifikimi rezultoi se këto detyrime janë pranuar dhe është kontabilizuar detyrimi. Është arkëtuar vlera 152,000 lekë duke mbetur pa arkëtuar shuma 1,287,650 lekë, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **9. BASHKIA KUKËS**

Nga KLSH me shkresën nr. 267/13 prot., datë 25.7.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Kukës, për shpërblimin e dëmit me vlerë **71,708,760 lekë,** dhe nga verifikimi rezultoi se Bashkia Kukës për çdo rast ka nxjerrë urdhër zhdëmtimi. Nuk është zbatuar rekomandimi për vjeljen e shumës 1,699,200 lekë nga 1 subjekt, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre dhe vazhdimin e procedurave për shpërblimin e dëmit ekonomik** si më poshtë:

-arkëtimin e shumës prej **282,750 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L.D, A.C, dhe F.T. Fond limit në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj),.

- arkëtimin e shumës prej **548.260 lekë** nga preventivuesi M.G. Fond limit në **4 tendera të zhvilluar me objekt: “Blerje ushqimesh”**.

- arkëtimin e shumës prej **126.200 lekë**, nga Përgjegjëse e Zyrës së Shpenzimeve, A.Z, Drejtor i Shërbimeve F.T, magazinierja M.C, dhe Drejtori Ekonomik L.D. Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje materiale për shërbime të ndryshme”.

- për arkëtimin e shumës prej **500,659 lekë**, sigurim oferte, nga OE [REDACTED] shpk.

- për arkëtimin e shumës prej **800,477 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L.D, A.C, dhe F.T.

- për arkëtimin e shumës prej **190,000 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L.D, A.C, dhe F.T. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje konteniere mbetjesh urbane”.

- për arkëtimin në vlerën **854,683 lekë** nga operatori ekonomik [REDACTED] sh.p.k., për situacionimin e volumeve të punimeve për 4 zëra punimesh, në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Havzi Nela”.

- për arkëtimin në vlerën **875,509 lekë** nga operatori [REDACTED] sh.p.k. për situacionimin e volumeve të punimeve për 15 zëra punimesh në objektin “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të qytetit të Kukësit”.

- për arkëtimin **dëmit ekonomik në shumën prej 403,287 lekë** nga Kryetari dhe Drejtori Ekonomik, të cilët në tejkallim të kompetencës ligjore, kanë kryer veprime e pranuar likuidime të detyrimeve të tatim taksave të **4 subjekteve** në vlerën **403,287 lekë**, në kompensim të detyrimeve të Bashkisë për blerje mallrash materialesh lëndë djegëse, punimesh me situacion.

- Bashkia Kukës të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur administrativ e ligjor, për të kërkuar arkëtimin dhe shlyerjen e vlerën prej **50,716,000 lekë** të ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në ndaj personave shkaktar nga përdorimi i paligjshëm dhe pa tituj pronësie për periudhën prej 1,5 vjet të pronave të Bashkisë të llojit truall me sipërfaqe prej 21,420 m<sup>2</sup>, ndërtesa me sipërfaqe ndërtimi 1487 m<sup>2</sup> dhe 239 apartamenteve banimi, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja, administrimi Funkcionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit, ndërtesa të ish-NB dhe ish ndërmarrjeve ekonomike”.

- Bashkia Kukës të marrë masa duke ndjekur hapat e duhur ligjor dhe të kontabilizojë dhe kërkojë shlyerjen e të ardhurave të munguara dhe dëmin ekonomik në vlerën **888,000 lekë**, ndaj punonjësve shkaktar, rrjedhur nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën korrik 2013- dhjetor 2014, gjatë 1,5 vjet të sipërfaqes prej 74 ha kullotë

- Vlera qira trualli e pa paguar për 12 raste të lejeve të përdorimit ku trualli i ka kaluar përdoruesve të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,699,200 lekë (1191 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj).

- Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore **shpërblimi i dëmit në vlerën prej 5,805,000 lekë**, për 10 kontrata truall i kaluar në pronësi, qira trualli e pa arkëtuar.

-Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **prej 744,448 lekë**, kalim në pronësi të apartamenteve pa pagesë.

**BASHKIA KUKËS (Ish-Komuna Grykë-Çajë)**

Nga KLSH me shkresën nr. 573/7 prot., datë 24.9.2015 i ka rekomanduar ish-Komunës Grykë Çajë, për shpërblimin e dëmit me vlerë 129,500 lekë, të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, janë nxjerr urdhrat për zhdëmtimin e vlerës, por ende nuk ka filluar arkëtimi, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **10. BASHKIA KUÇOVË**

Nga KLSH me shkresën nr. 32/6, datë 30.4.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Kuçovë, për shpërblimin e dëmit me vlerë **24.966.132 lekë**, për 15 masa. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga Bashkia Kuçovë sipas shkresës nr. 51/49, datë 25.05.2015 dërguar në KLSH. Nga 24,966,132 lekë të rekomanduara janë arkëtuar 1,057,861 lekë për 3 masa dhe nuk janë arkëtuar dhe as kontabilizuar vlera 23,908,2711 lekë për 12 masa, **për të cilat do rikërkojmë zbatimin e masave për kontabilizim dhe arkëtimin e tyre.**

#### **11. BASHKIA PATOS**

Nga KLSH me shkresën nr. 31/11, datë 7.9.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Patos, për shpërblimin e dëmit me vlerë **8,310,700 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim është pranuar i pjesshëm sipas shkresës nr. 1542/100, datë 21.9.2015 dërguar pranë KLSH, pasi nga subjekti ka patur disa kundërshtime të rekomandimeve, për rrjedhojë Bashkia Patos nuk ka kryer të gjitha ndalesat dhe ka zbatuar në mënyrë të pjesshme masat e zhdëmtimit sipas plan veprimit të miratuar nr. 1542/102, datë 29.9.2015.

Nga 10 masa për shpërblim dëmi për vlerën 8,310,700 lekë, janë pranuar dhe kontabilizuar pjesërisht, për vlerën 1,845,894 lekë **duke mos pranuar** 9 masa zhdëmtimi për vlerën 8,237,699 lekë, **për të cilat do rikërkojmë zbatimin e tyre.**

#### **12. BASHKIA PUKE**

Nga KLSH me shkresën nr. 240/6, datë 30.6.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Pukë për shpërblimin e dëmit me vlerë **302,141 lekë**, për 2 masa.

Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga Bashkia Pukë sipas shkresës shkresa nr. 137/37, datë 16.6.2015 dërguar në KLSH dhe është në proces, prandaj **do rikërkojmë zbatimin e masave për arkëtimin e tyre.**

#### **13. BASHKIA KUÇOVË (ISH-KOMUNËN PERONDI)**

Nga KLSH me shkresën nr. 240/6, datë 30.6.2015 i ka rekomanduar ish-Komunës Perondi për shpërblimin e dëmit me **vlerë 7,437,110 lekë**, për 9 masa. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga Bashkia Kuçovë, sipas shkresës shkresa nr. 320/3, datë 8.7.2015 dërguar në KLSH. Masat e zhdëmtimit për vlerën 7,437,110 lekë, për 9 masa nuk janë zbatuar, nuk është kryer kontabilizimi dhe nuk është kryer asnjë ndalesë. Këto masa për shpërblim dëmi kanë pasur mundësi arkëtimi pasi disa punonjës aktualisht kanë mardhënie pune me Njësinë Administrative

Perondi. Për masat e zhdëmtimit të mësipërme, do rikërkojmë zbatimin dhe arkëtimin e tyre.

#### 14. BASHKIA DURRËS

Nga KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Durrës masa për shpërblim dëmi në vlerën **47,509,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Durrës, **janë pranuar** të gjitha detyrimet e rekomanduara, por edhe pse janë njoftuar subjektet për shpërblimin e dëmit ekonomik, ende nuk kishin filluar procedurat e arkëtimit, **prandaj rikërkojmë të vazhdojnë procedurat për arkëtimin vlerës mbetur prej 47,509,000 lekë**.

#### 15. BASHKIA KAVAJË

Nga KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Kavajë masa për shpërblim dëmi në vlerën **29,705,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se deri më datën 14.12.2015, janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën 28,048,000 lekë, **nuk janë pranuar** dem ekonomik vlera prej **657,000 lekë**. Nga kjo vlerë janë arkëtuar 1,261,000 lekë duke mbetur në proces zbatimi vlera 28,444,000 lekë, për të cilin **do rikërkojmë** zbatimin e tyre.

#### 16. BASHKIA VORË

Nga KLSH i është rekomanduar ish-Komunës Prezë, masa për shpërblim dëmi në vlerën **4,736,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se deri më datën 18.11.2015 nga Kryetari i Bashkisë Vorë **janë pranuar** rekomandimet duke nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën 4,736,000 lekë, arkëtuar vlera 34,000 lekë, duke mbetur në proces zbatimi edhe vlera prej 4,702,000 lekë, për të cilat do ti **rikërkojmë** Bashkisë Vorë, arkëtimin e detyrimeve të rekomanduara nga KLSH.

#### 17. BASHKIA KRUIJË

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Krujë për detyrimet e krijuara nga ish-Bashkia Fushë-Krujë, masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,445,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se **janë pranuar** rekomandimet dhe deri më datën 26.11.2015 nga Bashkia Krujë, janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën 2,149,000 lekë. Nga ky detyrim ishte arkëtuar vlera 279,000 lekë, nuk janë pranuar detyrimi në vlerën 296,000 lekë, për shpenzime karburanti, duke mbetur në proces arkëtimi edhe vlera prej 2166,000 lekë, për të cilën **do rikërkojmë zbatimin** e tyre.

#### 18. BASHKIA LEZHË (ISH-KOMUNA SHENGJIN)

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Lezhë, për detyrimin e krijuar nga ish-Komuna Shëngjin masa për shpërblim dëmi në vlerën **25 127 000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se **janë pranuar** rekomandimet dhe deri më datën 09.12.2015 nga Bashkia Lezhë, janë nxjerrë urdhrat për kontabilizimin e detyrimeve, por ende nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit, për të cilat **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve** të



rekomanduara nga KLSH në vlerën **25 ,127, 000** lekë.

#### **19. BASHKIA ELBASAN (ISH-KOMUNA BRADASHESH)**

Nga KLSH i është rekomanduar ish-Komunës Bradashesh masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,841,007 lekë**. Nga verifikimi rezulton **janë pranuar** rekomandimet dhe deri më datën 18.11.2015 nga Bashkia Elbasan, janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën 2,841,007 lekë, por ende nuk ka filluar arkëtimi, për të cilën do **rikërkojmë nga Bashkisë Elbasan arkëtimin e detyrimeve** të rekomanduara nga KLSH në vlerën **2,841,007 lekë**.

#### **20. BASHKIA DIVJAKË**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Divjakë masa për shpërblim dëmi në vlerën **1,647,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se deri më datën 3.12.2015 nga Bashkia Divjakë, janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim. Nga ky detyrim janë arkëtuar 18 000 lekë, **nuk janë pranuar si detyrim** vlera prej **1,317,000 lekë**, me arsyetimin se skualifikimi i subjektit është i saktë duke paraqitur dokumentacionin e munguar, për të cilën nuk është dakord grupi i auditimit, prandaj do **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve të rekomanduara nga KLSH në vlerën 1,629,000 lekë**, ku përfshihet dhe detyrimi i pa pranuar. Në se nuk filloni procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, KLSH do të kërkojë pranë organeve të prokurorisë që personat fajtorë të përgjigjen për shpërdorim detyre.

#### **BASHKIA DIVJAKË (ISH-KOMUNA GRADISHT)**

Nga KLSH i është rekomanduar ish - Komunë Gradisht, masa për shpërblim dëmi në vlerën **1,361,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se deri më datën 02.12.2015 nga Bashkia Divjakë, janë pranuar rekomandimet duke nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën **1,361,000 lekë**, janë arkëtuar vlera 183 000 lekë, duke mbetur në proces zbatimi edhe vlera prej 1,178,000 lekë, për të cilën do **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve** të rekomanduara nga KLSH në vlerën **1,178,000 lekë**.

#### **21. BASHKIA POGRADEC**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Pogradec **masa për shpërblim dëmi** në vlerën **22,778,038 lekë**. Nga verifikimi rezulton **se janë pranuar** rekomandimet dhe deri më datën 18.11.2015 nga Kryetari i Bashkisë Pogradec janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën **22,778,038 lekë**, por ende nuk ka filluar arkëtimi, prandaj do **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve** të rekomanduara nga KLSH.

#### **BASHKIA POGRADEC ISH (KOMUNA ÇERRAVE)**

Nga KLSH i është rekomanduar **ish-Komunës Çerrave**, masa për shpërblim dëmi në vlerën **5,282,000 lekë**. Nga verifikimi rezulton se deri më datën 12.11.2015 nga Bashkia Pogradec, **janë pranuar** rekomandimet duke nxjerrë urdhrat për zhdëmtim

në vlerën 4 736 000 lekë, janë arkëtuar vlera **300,000 lekë** dhe mbetur në proces zbatimi edhe vlera prej **4, 982,000 lekë**, për të cilën do **rikërkojmë** zbatimin e tyre.

## **22. BASHKIA MIRDITË (ISH-KOMUNA FAN)**

Nga KLSH i është rekomanduar ish-Komunë Fan, masa për shpërblim dëmi **në vlerën 352, 424 lekë**, nga 7 rekomandimet e lëna nuk është zbatuar asnjë, prandaj do **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve** të rekomanduara nga KLSH në **vlerën 352,424 lekë**.

## **23. UJËSJELLËS SHA BERAT-KUÇOVE**

Nga KLSH me shkresën nr. 31/11, datë 7.9.2015 i ka rekomanduar UK Berat-Kuçove për shpërblimin e dëmit me vlerë **8,697,584 lekë** në 13 masa. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga UK Berat-Kuçove sipas shkresës shkresa nr. 132, datë 20.3.2015 dërguar në KLSH. Nga vlera e rekomanduar prej 8,697,584 lekë janë arkëtuar shuma 586,334 lekë duke mbetur në proces arkëtimi shuma 8,111,250 lekë, **për të cilat do rikërkojmë zbatimin e masave për arkëtimin e tyre.**

## **24. ZVRPP KRUIJË**

Nga KLSH i është rekomanduar ZVRPP masa **për shpërblim dëmi** në vlerën **2,720,000 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 23.11.2015 nga Regjistruesi, janë nxjerrë urdhrat për zhdëmtim në vlerën **2,720,000 lekë**, duke u arkëtuar vlera 912, 000 lekë dhe mbetur në proces zbatimi edhe vlera prej vlerën 1 808 000 lekë. prandaj do **rikërkojmë arkëtimin e detyrimeve** të rekomanduara nga KLSH.

## **25. ZVRPP SARANDË**

Nga KLSH, me shkresën nr. 673/10 prot., datë 31.1.2015, i ka rekomanduar ZVRPP Sarandë, për shpërblimin e dëmit me vlerë **6,420,152 lekë**.

Për arkëtimin e detyrimit bazuar në rekomandimin e KLSH-së, ZVRPP Sarandë ka nxjerrë urdhrin kufizimi për pasuritë me nr. 1092-1107, datë 30.7.2015. Nuk është zbatuar rekomandimi për arkëtimin e shumës 174,750 lekë pasi është vlerë e llogaritur për kamat vonesa për mos marrje pjesë në çështje gjyqësore, të cilat nuk i janë faturuar ZVRPP Sarandë, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

## **26. ZVRPP POGRADEC**

Nga KLSH me shkresën nr. 1040/11 prot., datë 7.04.2015, i është rekomanduar ZVRPP Pogradec, për shpërblimin e dëmit me vlerë **303,500 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se **është pranuar** rekomandimi për arkëtimin e këtij detyrimi, regjistruesi ka nxjerrë urdhrin për kufizimin e pasurisë, është njoftuar personi debitor duke kontabilizuar detyrimin, por nuk kishte filluar arkëtimi i detyrimit, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

## **27. ALUIZNI KORÇË**

Nga KLSH me shkresën nr. 1063/13 prot., datë 20.3.2015, i është rekomanduar Drejtorisë Rajonalë të ALUIZNI Korçë, për shpërblimin e dëmit me vlerë **1,969,068 lekë** nga 16 persona. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim **është pranuar** nga ALUIZNI Korçë i cili i ka kthyer përgjigje KLSH-së me shkresën nr. 1058 prot., datë 14.4.2015. Në këtë datë, personat debitorë janë njoftuar zyrtarisht me postë për vlerën debitore. Janë kryer regjistrimet kontabël për vlerën e debisë 1,969,068 lekë, nuk ka filluar detyrimi i arkëtimit, për të cilat do **rikërkojmë zbatimin e tyre**.

## **C. MASAT DISIPLINORE**

Në 43 subjektet e verifikuara për zbatim rekomandimesh nga 507masa disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar 354 masa ose në masën 70 %, duke mos u zbatuar 153 masa, nuk kanë zbatuar masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH respektivisht: Bashkitë: Kavajë 26 masa, Fier 14 masa, Durrës 9 masa, Kukës 8 masa, Kuçovë 8 masa, Fushë-Krujë 10 masa, Patos 14 masa.

Bazuar në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 datë 18.12.2014; Kreu I- Organet Disiplinore, pikat 3 dhe 10, të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe nenin 64, shkronja (g) të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri “**Largim nga shërbimi civil**” për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil dhe për punonjësit të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, bazuar në nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës”, i ndryshuar, marrjen e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri në “**Zgjidhjen e marrëdhënieve të punës**”, në subjektet dhe personat si më poshtë:

### **1. BASHKIA TIRANË**

Nga 18 masa të rekomanduara nga KLSH, Bashkisë Tiranë, janë zbatuar 13 masa disiplinore “Vërejtje” duke mos u zbatuar edhe **5 masa disiplinore**, për të cilët i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë (Bashkisë), të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore:

**“Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 5 punonjësit** si më poshtë:

- 1. Z. E.M.** punonjës i AT, anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- 2. Z. E.T.** punonjës i AT, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit,

3. **Zj. E.B.** punonjës i AT, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit,
4. **Z. A.B.** punonjës i AT, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit,
5. **Z. L.L.** me detyrë P/sektoir Administrimit të Ndërmarrjeve

## 2. BASHKIA FIER

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Fier marrja e masës disiplinore nga “Vërejtje deri “**Largim nga shërbimi civil**” për 27 punonjës.

Nga verifikimi rezulton se janë zbatuar masat për 16 punonjës, **ndërsa për 12 punonjës** nuk është marre në konsideratë rekomandimi i KLSH për marrje masë disiplinore. Sa sipër i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, që të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për **12 punonjësit si më poshtë:**

1. **Zj. O.P**, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave, për kohën kur ka qenë me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Tatim Taksave,
2. **Zj. E.S**, aktualisht specialiste e Nivelit Lartë për vlerësimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave, për kohën që ka qenë me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Regjistrimit dhe Vlerësimit.
3. **Zj. L.N**, me detyrë specialist për kadastrën urbane
4. **Z. Z.R**, me detyrë specialist i arkivës teknike dhe kadastrës urbane
5. **Zj. E.Zh**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Buxhet-Financës.
6. **Zj. E.Dh**, me detyrë Jurist në Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave,
7. **Zj. H.T**, me detyrë Inxhinier në Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave.
8. **Zj. S.A**, me detyrë specialist për shqyrtimin e aplikimeve dhe regjistrin e planifikimit të territorit.
9. **Z.F.T**, aktualisht këshilltar ekonomik pranë Kryetarit të Bashkisë, për kohën kur ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik,
10. **Znj.A.S**, aktualisht Drejtor i Informacionit dhe Statistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO.
11. **Zj. A.V**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit të Pronave,
12. **Z. F.M**, aktualisht Drejtor i ruajtjes së objekteve, në Bashkinë Fier, **për shkeljet e konstatuara në kohën kur ka qenë në detyrën e ish-Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor Fier, (IMTV) nga data 02.12.2013 e në vazhdim të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”.**

## 3. BASHKIA HIMARË

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Himarë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore për 24 punonjës. Nga verifikimi rezulton se janë zbatuar 22 masa, duke mos u zbatuar 2 masa, **për të cilët rikërkojmë:**

1. Fillimin e ecurisë disiplinore, nga masë “**Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate**”, neni 9 shkronja “b”, të kontratës individuale, për **Z. S.M.** me detyrë përgjegjës sektori në Drejtorinë e MMT, në cilësinë e anëtarit të

komisionit për inventarizimin e aseteve.

2. **Zgjidhjen e kontratës së punës**, neni 9 shkronja “c”, e kontratës individuale, për **Z. A.P.** në cilësinë e Juristit në NJP në tenderin me objekt ‘Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’.

#### 4. **BASHKIA KUKËS**

Nga KLSH, i është rekomanduar Bashkisë Kukës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për 21 punonjës. Nga verifikimi rezulton se janë zbatuar 14 masa disiplinore, duke mos u zbatuar 7 masa, për të cilat i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 7 punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. N.C.**, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.
2. **Zj. M.C.**, me detyrë magazinierë e Bashkisë Kukës.
3. **Zj. F.L.**, me detyrë specialiste zyre sektori Të ardhurave.
4. **Z. D.R.**, me detyrë specialist terreni në sektorin e të ardhurave.
5. **Z. B.I.**, me detyrë specialist i sektorit të Pronave dhe Kadastrës.
6. **Z. E.E.**, me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.
7. **zj. L.N.**, me detyrë Specialist Ligjor dhe Protokollit.

#### 5. **BASHKIA KUÇOVË**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Kuçovë marrja e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga detyra” dhe për punonjësit me kontratë “Zgjidhje e kontratës së punës”, për 12 punonjës. Nga verifikimi rezulton se deri me datë 27.11.2015 nuk janë dhënë 8 masa disiplinore, prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, **për 8 punonjësit** e mëposhtëm:

1. **Sh.N.**, me detyrë ish -n/kryetar bashkie në cilësinë e kryetarit të KVO.
2. **H.Sh.**, me detyrë Drejtore e Financës, në cilësinë e kryetares të komisionit, “Për prokurimet me vlera të vogla” dhe KVO.
3. **G.Q.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në cilësinë e anëtarit të Njësisë prokurimit.
4. **O.Z.**, me detyrë specialist në Zyrën e Urbanistikës në cilësinë e anëtarit të Njësisë prokurimit.
5. **A.C.**, në cilësinë e anëtarit të NjP.
6. **Th.N.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë të të ardhurave Vendore.
7. **L.Z.**, me detyrë Inspektor i biznesit të vogël.
8. **D.S.**, me detyrë Inspektore e biznesit të vogël.
6. **BASHKIA KUÇOVË (ish-Komuna Perondi)**

Nga KLSH i është rekomanduar ish-Komunës Perondi, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për 4 persona, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për punonjësit me status të nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit me kontratë pune, masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”

Nga verifikimi rezulton se deri me datë 02.12.2015 nuk ishte zbatuar asnjë nga 4 masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, prandaj, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 4 **punonjësit e mëposhtëm:**

1. **Zj. R.B**, ish-Drejtores e financës, aktualisht me detyrë Administratore e Njesisë Perondi, pasi nuk ka vlerësuar dhe nuk ka zbatuar masat organizative dhe masat e zhdëmtimit të rekomanduara më parë nga KLSH, sipas shkresës nr. 240/6, datë 30.6.2015.
2. **Zj. B.M**, me detyrë arkëtare.
3. **Z. F.P**, me detyrë Drejtor i Urbanistikës dhe Ruajtjes së Ambientit.
4. **Zj. V.A**, me detyrë specialiste mjedisi dhe në cilësinë e anëtarit të njesisë së prokurimit.

## 7. **BASHKIA PUKË**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Pukë për marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për 8 punonjës, por nga verifikimi rezulton se deri me datë 10.11.2015 nuk janë dhënë 4 masa disiplinore, prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 4 punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. B.A**, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve.
2. **Zj. F.B**, Përgjegjëse e Sektorit të Financës.
3. **Zj. A.S**, ish- Përgjegjëse e Sektorit Juridik, juriste.
4. **Z. I.K**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me Vlera të Vogla.

## 8. **BASHKIA PATOS**

Nga KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Patos, fillimin e procedurave e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” dhe për punonjësit me kontratë, nga “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, por nga verifikimi rezulton se deri me datë 12.11.2015 nga 14 masa të rekomanduara, nuk janë dhënë 10 masa disiplinore. Prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për **10 punonjësit** e mëposhtëm:

1. **Z. A.S**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit të Vogël.

2. **Zj. S.M**, me detyrë Inspektore e taksës së popullatës.
3. **Zj. M.Sh**, me detyrë Drejtore e Financës:
4. **Zj. A.L**, me detyrë Drejtore e të Ardhurave Lokale.
5. **Z. Sh.B**, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore, njëkohësisht edhe pse nuk ka aplikuar masat disiplinore, në kundërshtim me plan veprimin e miratuar nga kryetarja e bashkisë Patos nr. 1542/102, datë 29.9.2015 dhe me shkresën e KLSH nr. 31/11, datë 7.9.2015.
6. **Z. H.M**, me detyrë Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
7. **Zj. S.G**, me detyrë Përgjegjëse e zyrës së Kadastrës
8. **Zj. N.M**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe të Kontrollit të Zhvillimit të Kadastrës;
9. **Z. R.B**, me detyrë specialist urbanistike.
10. **Z. I.K**, me detyrë jurist.

## 9. BASHKIA DURRËS

Nga KLSH, i është rekomanduar Bashkisë Durrës fillimin e procedurave për **dhënien e 37 masave disiplinore**, nga verifikimi **rezulton se janë zbatuar 27 masa disiplinore**, nga të cilët 3 punonjës janë larguar duke dhënë dorëheqje, 1 punonjës ka dale në pension pleqërie , ndërkohë nuk janë mare masa disiplinore edhe për 9 punonjës , për të cilët i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për **9 punonjësit e mëposhtëm:**

1. **Zj. D.D**, me cilësinë e anëtarit të KVO-së.
2. **Z. D.B**, me cilësinë e anëtarit të KVO-së.
3. **Z. A.B**, i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave të operatorit “NIKA”.
4. **Z. A.T**, i ngarkuar si anëtar i grupit punës shqyrtimin e ankesës të operatorit “Rikonstruksioni i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve”.
5. **Zj. E.S**, me cilësinë anëtarë i grupit të hartimeve të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes fondit limit.
6. **Zj. A.P**, me cilësinë e anëtarit të KVO-së
7. **Zj. A.H**, me cilësinë e anëtarit të KVO-së.
8. **Zj. R.K**, me cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim.
9. **Zj. E.K**, shefe e Sektorit Urbanistikës ligjo dhe marrëdhënie me publikun.

## 10. BASHKIA KAVAJË

Nga KLSH, i është rekomanduar Bashkisë Kavajë fillimin e masave disiplinore për **40 punonjës**, por nga verifikimi rezulton se janë dhënë vetëm 24 masa disiplinore ose në masën 60%, duke mos u zbatuar rekomandimi i KLSH edhe për 16 punonjës për të cilët i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë , të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 15 punonjësit **si më poshtë:**

- a) Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Kavajë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “**Largim nga shërbimi civil**” për **Zj. A.K**, Drejtore e Financës dhe “**Zgjidhjen e kontratës punës**” për **Zj. M.P**, Drejtore e Legjislacionit, nga verifikimi rezulton se nuk ishte dhënë asnjë masë disiplinore, prandaj do **rikërkojmë** edhe njëherë zbatimin e këtyre masave disiplinore.
- b) Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Kavajë për 12 punonjës dhënia e masave disiplinore “**Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj**”. Nga verifikimi rezulton se për 6 punonjës kjo masë është zëvendësuar me masën disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim**”, ndërsa për 6 punonjës të tjerë nuk u është dhënë masa disiplinore e rekomanduar nga KLSH, prandaj **do rikërkojmë** edhe njëherë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “**Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj**”, për 6 punonjësit e mëposhtëm:
1. **Z. A.M**, me detyrë përgjegjës i sektorit të menaxhimit kontratave.
  2. **Z. Th.D**, me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Tatim Taksave.
  3. **Z. D.K**, me detyrë përgjegjësi i Sektorit të menaxhimit të biznesit.
  4. **Znj. S.Sh**, me detyrë specialist biznesi.
  5. **Znj. S.M**, me detyrë me detyrë
  6. **Z. J.Ç**, me detyrë Përgjegjës i sektorit Borxhit dhe Taks- Forcës
- c) Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Kavajë për 14 punonjës fillimin e procedurave për marrjen e masës disiplinore nga “**Vërejtja**” deri në “**Largimin nga shërbimi civil**”. Nga verifikimi rezulton se janë zbatuar 6 masa disiplinore, duke mos u zbatuar për 7 punonjës , për të cilat do **rikërkojmë** edhe njëherë zbatimin e kësaj mase për 7 **personat si më poshtë**:
1. **Zj. P.M**, me detyrë llogaritare magazinierë
  2. **Z. R.G**, me detyrë specialist page
  3. **Zj. V.B**, me detyrë llogaritare e të ardhurave
  4. **Zj. T.D**, me detyrë supervizore e pastrimit
  5. **Zj. A.H**, me detyrë specialiste
  6. **Z. D.A**, me detyrë specialist
  7. **Z. B.L**, me detyrë veteriner

#### 11. **BASHKIA KRUIJË** (ish -Bashkia Fushë-Krujë)

Nga KLSH i ka rekomanduar ish -Bashkisë Fushë-Krujë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për 14 punonjës nga “**Vërejtja**” deri në “**Largimin nga detyra**”. Nga verifikimi rezulton se nga 14 masa disiplinore ishin zbatuar masat për 4 punonjës, ndërsa **për 10 punonjës nuk është zbatuar masa e rekomanduar nga KLSH** për të cilët i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga Shërbimi civil**”, për 10 punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. R.T**, me detyrë Zv/ kryetar Bashkie.
2. **Z. A.D**, me detyrë inxhinier ndërtimi.



3. **Zj. L.N**, me detyrë inspektore e licencimit.
4. **Zj. A.H**, me detyrë inspektore e licencimit.
5. **Z. I.K**, me detyrë inxhinier arkitekt.
6. **Z. M.D**, me detyrë Përgjegjësi i Sektorit Burimeve Njerëzore.
7. **Zj. N.Ll**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të AMT.
8. **Zj. Xh.Xh**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Financave.
9. **Z. Z.Gj**, me detyrë Inspektor Kontrolli.
10. **Z. E.K**, me detyrë Inspektor Kontrolli.

## 12. **BASHKIA LEZHË (ISH-KOMUNA SHËNGJIN)**

Nga KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Lezhë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, për 23 punonjës të ish-Komunës Shëngjin. Nga verifikimi rezulton se deri me 09.12.2015 ishin zbatuar rekomandimet e KLSH, për 21 persona, duke mos u zbatuar masa disiplinore edhe për 2 punonjës. Prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërktojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, **ndaj 2 punonjësve:**

1. **Z. P.N**, me detyrë, specialist në Zyrën e Turizmit.
2. **Z. K.K**, me detyrë ish përgjegjës në Zyrën e Kadastrës dhe Shërbimit Pyjor.

## 13. **BASHKIA ELBASAN (ISH-KOMUNA BRADASHESH)**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Elbasan, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” për 2 punonjës. Nga verifikimi rezultoi se nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërktojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 2 punonjësit si më poshtë:

1. **Zj. Dh.B**, me detyrë Inspektore e ndihmës ekonomike.
2. **Z. Y.A**, përgjegjës i Zyrës së Kontroll Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit.

## 14. **BASHKIA POGRADEC (ISH-KOMUNA ÇERRAVE)**

Nga KLSH, i është rekomanduar ish-Komunës Çeravë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje” për 6 punonjës, por nga verifikimi rezulton se deri me datë 2.12.2015 ishin zbatuar masat disiplinore për 2 punonjës, ndërkohë që nuk është zbatuar masa disiplinore edhe për 4, punonjës për të cilët i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërktojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, **për 4 punonjësit e mëposhtëm:**

11. **Z. Nertil Hoxha**, me detyrë përgjegjës i Zyrës Tatim Taksa.
12. **Z. E.Sh**, specialist i urbanistikës, anëtar njësisë prokurimit
13. **Zj. B.C**, arkëtare, anëtare e njësisë prokurimit.

14. **Z. N.S**, anëtarë i KVO-së.

#### 15. **BASHKIA MIRDITË (ISH-KOMUNA FAN)**

Nga KLSH, i është rekomanduar ish -Komunës Fan), fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga verifikimi rezulton se deri me 11.12. 2015 nuk janë dhënë masa disiplinore të propozuara. Prandaj i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkohet** Komisionit disiplinor (KD), pranë Bashkisë), të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për **3 punonjësit e mëposhtëm:**

15. **Z. Gj.K**, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës.

16. **Zj. L.Ll**, anëtare e KVO-së

17. **Z. Gj.Gj**, anëtarë i KVO-së

#### 16. **DREJTORIA E PËRGJITHSHËME E ALUIZNI-t TIRANË**

KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë, marrjen e masave disiplinore për 7 punonjës të Drejtorisë Rajonale të Fier dhe Korçë dhe nga verifikimi rezultoi se këto masa nuk janë zbatuar. Prandaj bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, **i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”, për **7 punonjësit** e mëposhtëm:

##### **PËR DREJTORINË RAJONALE -FIER.**

1. **Z. E.B**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUZNI-t Fier.

2. **Z. R.H**, me detyrë Përgj. i Sektorit të Legalizim e Urbanizimit ALUZNI-t Fier.

3. **Z. A.Dh**, me detyrë specialit në sektorin e urbanizimit të ALUZNI-t Fier.

4. **Zj. D.M**, me detyrë specialiste e llogaritjes së faturave të ALUZNI-t Fier.

5. **Zj. H.D**, specialiste e llogaritjes së faturave në Drejtorinë Rajonale Fier.

##### **PËR DREJTORINË RAJONALE -KORÇË.**

1. **Z. I.B**, me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Korçë.

2. **Z. A.N**, me detyrë specialist i llogaritjes së faturave në Drejtorinë Rajonale të ALUZNI-t Korçë.

#### 17. **PËR ZYRËN QENDRORETË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME (ZQRPP)**

Nga KLSH, i është rekomanduar Kryeregjistruesit të ZQRPP marrja e masave disiplinore ndaj 5 punonjësve të ZVRPP Sarandë dhe Krujë, por nga verifikimi rezulton se këto rekomandime nuk janë zbatuar. Prandaj mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr.

9125, datë 29.07.2003 dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës i **rikërkojmë** Kryeregjistruesit të ZQRPP të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, “Vërejte me shkrim”, për 5 punonjës në 2 subjektet si më poshtë:

### **PËR ZVRPP SARANDË**

Fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje” deri “Zgjidhje e marrëdhënieve të Punës”, për:

1. **Zj. E.A**, me detyre ish Përgjegjëse Sektorit Hartografisë, aktualisht juriste.
2. **Zj. L.D**, me detyrë specialiste.
3. **Zj. E.B**, me detyrë specialiste arkive.

### **PËR ZVRPP KRUIJË**

Fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje” deri “Zgjidhje e marrëdhënieve të Punës”, për:

1. **Z. B.V**, me detyrë jurist-P/Spektori Regjistrimit Fillestar në zonat rurale
2. **Zj. Xh.M**, me detyrë jurist-P/Spektori Regjistrimit Fillestar në zonat urbane.

## **PER MASAT ADMINISTRATIVE**

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, **u rikërkojmë** Kryetareve të Bashkive dhe Kryeinspektorëve të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, të zbatojnë procedurat ligjore për nxjerrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e **50 vendimeve të gjobave në vlerën 5,300,000** lekë, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 2% në ditë deri 30 ditë, ose 60% mbi vlerën e gjobës për personat si më poshtë:

### **1. BASHKIA VLORË (NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM)**

Nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Vlorë, të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e gjobës në vlerën 70,000 lekë, vendosur ndaj **Zj. E.V**, kolaudator i punimeve, sipas vendimit nr.00105 datë 17.04.2015, nxjerr nga ish- INUV Bashkia Orikum, për shkeljet e konstatuara në objektin “Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas”.

### **2. BASHKIA SELENICË (NJËSIA ADMINISTRATIVE KOTË DHE VLLAHINË)**

Nga KLSH i është rekomanduara Kryeinspektorit të IMTV Bashkisë Selenicë, Vlorë që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, por ky rekomandim nuk është zbatuar, prandaj **i rikërkojmë** Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit (IMKT) Bashkisë Selenicë , që të vendosë gjobë, për shkeljet e konstatuara në Njësine Administrative Kotë , si më poshtë:

1. **Zj. N.M**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit;
2. **Z. S.Sh**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit
3. **Zj. E.V**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit
4. **Z. T.N**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit
5. **Zj. D.Xh**, mbikëqyrëse e punimeve, për shkeljet e konstatuara në Njësinë Administrative Vllahinë.

### 3. **BASHKIA FIER.**

Nga KLSH i është rekomanduar Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes Mjedisit , Bashkia Fier, të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë për subjektin ██████ sh.p.k, me ing. **G.G. dhe ing. F.G.** në cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, por ende nuk kishin filluar procedurat ligjore për zbatimin e këtij rekomandimi, prandaj i rikërkojmë IMTV Bashkia Fier, zbatimin e këtij rekomandimi.

### 4. **BASHKIA KUKËS**

Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Kukës, të marrë masë administrative me gjobë ndaj 3 mbikëqyrësve të punimeve dhe të kërkojë arkëtimin e tyre si **më poshtë:**

1. **Subjekti ██████ shpk**, me përfaqësues ligjor Zj. R.N. me licencë nr. MK 1507/1.
2. **Z. N.B**, mbikëqyrës i punimeve me licencë nr. MK 1631.
3. **Zj. Sh.Gj**, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 1280.

### 5. **BASHKIA PUSTEC**

Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Pustec, të marrë masë administrative me gjobë ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve dhe të kërkojë arkëtimin e tyre si **më poshtë:**

1. **Z. B.B**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. **Z. P.P**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

### 6. **BASHKIA PUKË**

Nëpunësi zbatues të kryejë kontabilizimet dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e 4 gjobave të vendosur nga APP në vlerën 170,000 lekë, për 4 personat si më poshtë:

1. **Zj. L.H**, inxhinier e Urbanistikës, anëtare e Njësisë së Prokurimit për vitin 2014 dhe anëtare e KVO për vitin 2013, gjobë **20,000 lekë.**
2. **Z. B.A**, specialist i shërbimeve në pozicionin, Kryetar i KVO për vitin 2013 dhe vitin 2014, gjobë **50,000 lekë.**
3. **Zj. L.P**, financiere në pozicionin anëtare e KVO për vitin 2013 gjobë **50,000 lekë.**
4. **Zj. N.D**, inspektore e ndihmës ekonomike përgjegjëse për specifikimet teknike,

gjobë **50,000 lekë**.

## **7. BASHKIA PATOS**

a.Për shkelje të procedurave të prokurimit publik, KLSH i ka rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik, që të vlerësojë shkeljet duke vendosur masa administrative (dënim me gjobë), bazuar në këtë rekomandim të KLSH, Agjencia e Prokurimit Publik me **vendimin nr.7, datë 15.1.2016** ka shqyrtuar dhe ka marrë masa me gjobë dhe ka propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos, marrjen e masave disiplinore për 10 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit, në vlerën 600,000 lekë *si më poshtë:*

- 1.A.K. 80,000 lekë,**
- 2.D.K. 50,000 lekë,**
- 3B.P. 50,000 lekë,**
- 4.V.Zh. 80,000 lekë,**
- 5.A.V. 60,000 lekë,**
- 6.V.N. 60,000 lekë,**
- 7.N.C. 60,000 lekë,**
- 8.A.L. 60,000 lekë,**
- 9.H.B. 50,000 lekë,**
- 10.N.M. 50,000 lekë,**

b.Nëpunësi zbatues të kryejë kontabilizimet e 2 gjobave dhe Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Patos, të zbatojë procedurat ligjore për arkëtimin e 2 gjobave për vlerën 100,000 lekë, sipas vendimit nr. 2, datë 23.9.2015 dhe nr. 3, datë 23.9.2015, ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve si më poshtë:

- 1. Zj. F.G. në masën 50,000 lekë,**
- 2. Z. T.N. në masën 50,000 lekë.**

## **8. SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË**

Bazuar në rekomandimin e KLSH, ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve IMTV Berat ka zbatuar dhe vendosur 2 gjoba për vlerën 200,000 lekë, sipas vendimit nr. 46, datë 24.11.2015 dhe nr. 47, datë 24.11.2015. Nga verifikimi rezultoi se deri me datën 25.11.2015 nuk kishte filluar arkëtimi i vlerës gjobave. Prandaj Nëpunësi zbatues të kryejë kontabilizimet e 2 gjobave dhe Ujësjiellës sha **Berat-Kuçovë, ti kërkojë** Kryeinspektorit të IMTV Bashkisë Berat që të vazhdojnë procedurat e ekzekutimit për gjobat e vendosura ndaj 2 mbikëqyrësve në vlerën 200, 000 lekë, përkatësisht:

- 1. Zj. V.J, mbikëqyrëse e punimeve në masën 100,000 lekë**
- 2. Z. L.N, mbikëqyrës i punimeve në masën 100,000 lekë**

## **9. BASHKIA DURRËS**

Nëpunësi zbatues të kryejë kontabilizimet e 2 gjobave dhe Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Durrës, të zbatojë procedurat ligjore për arkëtimin e 2 gjobave **për vlerën 150,000 lekë, ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve si më poshtë:**

1. **Z. E.Sh**, me gjobe në vlerën **100 000 lekë**.
2. **Z. T.S**, me gjobë në vlerën **50 000 lekë**.

## 10. BASHKIA KAVAJË

### Për masat administrative te rekomanduar IMTV.

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar bazuar në rekomandimi e KLSH Kryeinspektori i IMTV Kavajë ndaj 3 mbikëqyrësve dhe 2 kolaudatorëve të punimeve, ka vendosur gjobë në vlerën gjithsejtë 1.250,000 lekë, por nuk ka filluar ende arkëtimin e tyre. Prandaj i rikerkojmë Nëpunësit zbatues të Bashkisë Kavajë që të kontabilizojë **vlerën e gjobave prej 1,250,000 lekë**. Ndërsa Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit të zbatojë procedurat ligjore për ekzekutimin e 6 vendimeve të gjobave në vlerën **1 250 000 lekë**, si më poshtë:

1. **Zj. L.P**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **100 000 lekë**.
2. **Zj. F.V**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**
3. **Z. Gj.V**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**
4. **Zj. F.Ç**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**
5. **Zj. F.K**, kolaudator i punimeve gjobë në masën **500 000 lekë**
6. **Z. I.D**, kolaudatori i punimeve gjobë në masën **500 000 lekë**.

### Për masat administrative dënim me gjobë të vendosura nga APP

Për shkelje të procedurave të prokurimit publik, KLSH i ka rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik, që të vlerësojë shkeljet duke vendosur masa administrative (dënim me gjobë), bazuar në këtë rekomandim të KLSH, APP me vendimin nr.18, datë 07.03.2016, ka dënuar më gjobë në vlerën **1.040,000 lekë**, 9 personat për të cilët i rikërkojmë Bashkisë Kavajë (Nëpunësit Zbatues) që të kryhen kontabilizimet dhe pasi të priten afatet e ankimit (nëse ka) të fillojnë procedurat e për kryerjen e ndalesave deri në arkëtimin e vlerën **prej 1.040,000 lekë për 9 personat** si më poshtë:

1. **Z. A.M**, anëtar i KVO,P/ Sekt Menaxhimit Kontratave gjobë në masën **200,000 lekë**.
2. **Zj. I.Sh**, kryetare e KVO, Drejtore e Kabinetit, gjobë në masën **100,000 lekë**.
3. **Z. E.A**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, gjobë në masën **100,000 lekë**.
4. **Z. D.K**, anëtar i KVO, Përgjegjës i menaxhimit të Biznesit (ekonomist). gjobë në masën **100,000 lekë**.
5. **Zj. M.D**, Specialiste në Sektorin e Prokurimeve gjobë në masën **60,000 lekë**.
6. **Zj. A.H**, specialiste Urbanistikës, gjobë në masën **100,000 lekë**
7. **Z. E.B**, anëtar i KVO, ish drejtor i Urbanistikës, gjobë në masën **150,000 lekë**.
8. **Z. Th.D**, anëtar i KOV, Drejtor i Taksave dhe tarifave gjobë në masën **150,000 lekë**.
9. **Z. A.L**, anëtar i Njësisë Prokurimit, ish specialist gjobë në masën **80,000 lekë**.

## 11. BASHKIA KRUIË (ISH-BASHKIA FUSHË-KRUIË)

Nëpunësit zbatues të kontabilizojë **vlerën e gjobave prej 700,000 lekë**. Ndërsa Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit të Bashkisë të zbatojë procedurat ligjore për ekzekutimin e 5 vendimeve të gjobave në vlerën **700,000 lekë**, si më poshtë:

1. **Z. R.A**, nën cilën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**.
2. **Z. G.K**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**.
3. **Z. E.D**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **500 000 lekë**.
4. **Z. E.N**, mbikëqyrësi i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**.
5. **Z. B.M**, mbikëqyrës i punimeve gjobë në masën **50 000 lekë**.

## 12. **BASHKIA DIVJAKË (ISH-KOMUNA GRADISHTË)**

Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit të Bashkisë Divjakë, të marrë masë administrative për dënimin me gjobë dhe të kërkojë arkëtimin e saj ndaj mbikëqyrësit të punimeve **Z. R.B**.

## 13. **BASHKIA ELBASAN (ISH-KOMUNA BRADASHESH)**

Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Elbasan të marrë masë administrative me gjobë dhe të kërkojë arkëtimin e tyre ndaj 2 mbikëqyrësve **si më poshtë**:

1. **Për Subjektin** ██████████ shpk, përfaqësuar nga **K.M**. mbikëqyrës i punimeve,
2. **Për Z. Dh.D**, mbikëqyrës i punimeve

## 14. **BASHKIA KUÇOVË (ISH KOMUNA PERONDI)**

Nga KLSH për shkelje të rregullave të zbatimit të punimeve i ka rekomanduar ish-Komunës Perondi, vendosjen e dënimin me gjobë ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve. Nga verifikimi rezultoi se nuk janë zbatuar këto masa, **prandaj i kërkojmë** Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit të Bashkisë **Kuçovë** të fillojë procedurat ligjore për dënimin me gjobë për 2 mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:

1. **Zj. V.Z, mbikëqyrës i punimeve**, me licencë nr. MK 1148, me të cilën është lidhur kontrata nr. 879, datë 22.10.2012, me vlerë të përcaktuar 573,000 lekë, pa TVSh, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i rrugës Magjatë-Goraj-Velagosht, faza e I”, Komuna Perondi, për shkak se:
  1. **Zj. N.M. (Metohu), mbikëqyrës i punimeve**, me nr. MK 0992/2, me të cilën është lidhur kontrata me datë 01.10.2012, me vlerë të përcaktuar 480.000 lekë, pa TVSh, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Ndërtim i KUZ fshati Magjatë”, Komuna Perondi.

## 15. **BASHKIA POGRADEÇ**

Për shkelje të procedurave të prokurimit publik, KLSH i ka rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik, që të vlerësojë shkeljet duke vendosur masa administrative (dënim

me gjobë), bazuar në këtë rekomandim të KLSH, APP ka dënuar më gjobë 14 persona në vlerën **1,960,000 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se vlera e gjobave prej **1,960,000 lekë**, nuk ishte kontabilizuar dhe nuk kishin filluar procedurat për kryerjen e ndalesave, **prandaj i rikërkojmë Bashkisë Pogradec (Nëpunësit Zbatues)** që të kryhen kontabilizimet për vlerën **prej 1,960,000 lekë** dhe Kryeinspektori i IMTV Pogradec, të fillojnë procedurat ligjore për ekzekutimin e këtyre shumave **ndaj 14 personave** si më poshtë:

1. **Z. A.Sh**, me detyrë ish-Kryetari i Bashkisë gjobë në vlerën **500 000 lekë**.
2. **Z. D.H**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **300 000 lekë**.
3. **Zj. M.K**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **300 000 lekë**
4. **Zj. M.K**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **300 000 lekë**
5. **Zj. R.S**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **50 000 lekë**.
6. **Zj. I.Xh**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **50 000 lekë**.
7. **Z. E.M**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **50 000 lekë**.
8. **Zj. I.T**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **50 000 lekë**.
9. **Zj. F.B**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në masën **100 000 lekë**
10. **Zj. S.Ll**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **100 000 lekë**
11. **Zj. E.L**, me detyrë anëtarë i KVO-së, në vlerën **100 000 lekë**.
12. **Zj. M.Ç**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në masën **20 000 lekë**.
13. **Zj. Xh.T**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në vlerën **20 000 lekë**
14. **Zj. M.D**, me detyrë anëtarë i KVO-së, gjobë në masën **20 000 lekë**.

### **Shënim:**

Nuk kemi rikerkuar masa pasi i kemi konsideruar të realizuara, duke qene se disa masa për shpërblim demi janë hartuar paditë civile apo janë në proces gjyqësor, civil apo penal, **për 10 Subjektet:** Bashkitë: Dropull, Memaliaj, Shijak, (Xhafzotaj), Orikum, Kurbin, ZVRPP Kruje, Aluizni Fier, ish-Komuna Grykë Çajë-Kukës, Prefektura Shkodër etj.

Për hartimin e aktverifikimeve, procesverbaleve, raporteve përfundimtare të auditimit dhe projektvendimit përmbledhës, kemi hasur vështirësi në teren edhe për faktin e zbatimit të reformës territoriale, pasi pas datës 07.07.2015 pushuan së ekzistuari kompetencat e ish-Kryetarëve të Bashkive dhe Komunave, duke mbetur pa u zbatuar apo pezull mjaft rekomandime për arsye të transferimit të të drejtave dhe detyrave në Bashkitë e reja. Kjo në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit,aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".Edhe bashkimi i rekomandimeve **nga 45 subjekte sipas llojeve** dhe ish-komunat grupimi dhe sistemimi i qindra masave disiplinore dhe administrative në Bashkinë e madhe ka pasur vështirësitë e veta.

Me ndërhyrjen e grupeve të audituesve shtetërorë të KLSH, **mjaft** masa disiplinore u morën gjatë periudhës së verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, pasi disa nga Kryetarët e Bashkive dhe Njësitë e Burimeve Njerëzore nuk ishin në dijeni të krijimit dhe funksionimit të Komisioneve Disiplinore.

Bashkëlidhur 3 Pasqyrat për realizimin e demit ekonomik masave disiplinore dhe



administrative dhe masat organizative për 43 subjektet e verifikuara.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**